



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 janar 2018
Nr. ref.: RK 1181/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI117/17

Parashtrues

Avdullah Osmani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjkimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ – UZVP nr. 46/ 2017, të 3 gushtit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Avdullah Osmani nga Mitrovica (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ – UZVP nr. 46/ 2017, të 3 gushtit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se parashtruesit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 tetor 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 3 tetor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
7. Më 10 tetor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 7 dhjetor 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi kishte themeluar marrëdhënie të punës në shkollën fillore në Mitrovicë në pozitën e teknikut.
10. Më 12 maj 2009, drejtori i shkollës nxori Vendimin 226-2/09, me të cilin e suspendoi parashtruesin nga vendi i punës për shkak të moskryerjes së detyrave të tij punës.
11. Më 28 maj 2009, parashtruesi ushtroi ankesë kundër Vendimit 226-2/09 në Drejtorinë e Arsimit dhe Komisionin e Ankesave në Komunën e Mitrovicës.

12. Më 31 gusht 2009, parashtruesit të kërkesës i kishte përfunduar marrëdhënia e punës me skadimin e kontratës së punës.
13. Parashtruesi i kërkesës për shkak të heshtjes administrative të Drejtorisë së Arsimit dhe Komisionit të Ankesave në Komunën e Mitrovicës, paraqiti ankesë në Gjykatën Komunale në Mitrovicë.
14. Më 5 prill 2013, Gjykata Komunale në Mitrovicë nxori Vendimin C. nr. 126/2012, me të cilin e shpalli veten jokompetente për çështjen në fjalë. Me të njëjtin vendim, Gjykata e udhëzoi parashtruesin në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës (në tekstin e mëtejme: KPM) si organ kompetent për çështjen në fjalë.
15. Më 12 prill 2013, parashtruesi ushtroi ankesë në KPM për shkak të heshtjes administrative të Drejtorisë së Arsimit dhe Komisionit të Ankesave në Komunën e Mitrovicës përkitazi me ankesën të cilën e kishte ushtruar më 28 maj 2009.
16. Më 13 maj 2013, KPM-ja nxori Vendimin 02/166/2013, me të cilin e urdhëroi Drejtorinë e Arsimit dhe Komisionin e Ankesave që t'i përgjigjen parashtruesit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.
17. Drejtori i Administratës në Komunën e Mitrovicës i dërgoi një përgjigje KPM-së përkitazi me Vendimin e KPM 02/166/2013, në të cilën *inter alia* theksoi: *"...organi i punësimit e njofton KPM se ka refuzuar ankesën e parashtruesit për faktin se nuk ka detyrim ligjor ndaj ankuesit, për shkak se kontrata e tij e punës është përmbushur në të gjitha pikat"*.
18. Më 7 qershor 2013, parashtruesi paraqiti një ankesë të re në KPM, me të njëjtat pretendime, së bashku me kërkesën për kthim në vendin e punës.
19. Më 19 qershor 2013, KPM nxori Vendimin 02/238/2013, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.
20. Më 12 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Vendimit të KPM-së 02/238/2013. Parashtruesi kërkoi që t'i kompensohen të ardhurat personale të papaguara dhe të kthehet në punë.
21. Më 6 tetor 2016, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin A. nr. 421/14, me të cilin e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në arsyetimin e Aktgjykimit, ndër të tjera, thuhet:

"Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, iu referua Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2003/2, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut mbi Shërbimin Civil të Kosovës nr. 2001/36 ku përcakton se "punësimi në shërbimin civil përfundon automatikisht" në bazë të nenit 35 (b) pas skadimit të kontratës së punës së shërbyesit civil".
[...]

"...gjykata po ashtu vëren që nga dosja e lëndës shihet se paditësit i janë shqiptuar masa disiplinore ku ishte konstatuar se ka pasur një vërejtje të

fundit për ndërprerjen e kontratës së punës, përderisa me 12.05.1998 atij i është shqiptuar një masë disiplinore pasi ka shkelur detyrat e punës – kërcënim zyrtar dhe abuzim i detyrës zyrtare, dhe i është shqiptuar masa disiplinore Suspendim nga vendi i punës me pagesë të ardhurave personale ...”.

22. Parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, A. nr. 421/14.
23. Më 6 prill 2017, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin A. A. nr. 13/2017, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e Aktgjykimit, ndër të tjera, thuhet:

“Në bazë të rregullativës ligjore në fuqi, parashtruesi e ka pasur statusin e nëpunësit civil, dhe rrjedhimisht kontrata e tij e punës ka qenë për kohë të caktuar. Më datën 12.05.2009 i është shqiptuar masa disiplinore suspendim nga vendi i punës. Në ndërkohë, atij i ka skaduar kontrata e punës”.

24. Parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, A. A. nr. 13/ 2017.
25. Më 3 gusht 2017, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin ARJ – UZVP nr. 46/2017, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e Aktgjykimit, *inter alia*, thuhet:

“Meqenëse paditësi e kishte statusin e shërbyesit civil, dhe kishte kontratë pune në afat të caktuar, nga data 01.09.2008 deri më 31.08.2009, që do të thotë se paditësit i ka përfunduar marrëdhënia e punës me skadimin e kontratës së punës, ashtu siç parashihet me nenin 35. 1 (b) të UA nr. 2003/2, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai ka punuar 25 vjet në shkollë, se i ka kryer rregullisht detyrat e tij të punës, dhe se drejtori i shkollës dhe të tjerët nga administrata komunale kanë shkruar të pavërteta rreth tij. Për shkak të këtyre të pavërtetave, organet kompetente i kanë marrë vendimet që nuk janë në favor të tij.
27. Me këto vendime, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, shkelen të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] të Kushtetutës.
28. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që *“të shpallë të pavlefshme të gjitha vendimet e gjykatave, vendimet e KPM-së, si dhe të gjitha vendimet e tjera që janë marrë në dëm të tij”.*

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Gjykata në rastin konkret vëren se parashtruesi në kërkesën e tij ka qartësuar se cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë i janë cenuar me vendimet e gjykatave të rregullta, siç është përcaktuar me nenin 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, në të cilin thuhet:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

32. Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

33. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; kërkesa është parashtruar në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit dhe se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

34. Gjykata, më tej, i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

35. Gjkata vëren se parashtruesi i kërkesës, në thelb, ankohet për shkeljen e të drejtave dhe lirive kushtetuese sepse *“të gjitha organet dhe institucionet kanë marrë vendime që nuk janë në favor të tij”*.
36. Në këtë drejtim, Gjykata, para së gjithash, thekson se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) ka përcaktuar se *“është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale”* (shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I). ”
37. Gjykata, gjithashtu, thekson se vërtetimi i plotë i gjendjes faktike është në juridiksionin e plotë të gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumentet e tjera ligjore, prandaj ajo nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” (shih, GJEDNJ, rasti *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65; shih, po ashtu, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese, rasti KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, i 5 prillit 2012).
38. Me këtë rast, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Aktgjykimin A. nr. 421/14, gjeti se në pajtim me rregullativën ligjore në fuqi, parashtruesi e ka pasur kontratën njëvjeçare të punës për periudhën prej 1 shtatorit 2008 deri më 31 gushtit 2009. Gjykata gjithashtu vëren se pavarësisht nga fakti se atij i është shqiptuar masa disiplinore e suspendimit nga vendi i punës, ai i ka pranuar rregullisht të ardhurat personale nga punëdhënësi deri në skadimin e kontratës së punës.
39. Më tej, Gjykata vëren se me të njëjtat pretendime ankimore është marrë edhe Gjykata e Apelit, e cila përveç shqyrtimit të meritave të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, është marrë edhe me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të KPM-së. Lidhur me këtë, Gjykata e Apelit ka konkluduar se *“aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, si dhe vendimi përfundimtar i KPM-së janë të qarta, të ligjshme dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare”*.
40. Përveç kësaj, Gjykata nuk gjen se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ARJ – UZVP nr. 46/ 2017, është arbitrar, i pabazuar ose diskriminues sepse ai është i qartë, i arsyetuar në detaje dhe i bazuar juridikisht në rregulloret ligjore në fuqi, respektivisht në nenin 35. 1 (b) të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2003/2, me të cilën rregullohen marrëdhënia e punës dhe statusi i punonjësit në shërbimin publik, dhe e cila ka qenë e aplikueshme në atë periudhë kohore.
41. Si i tillë, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta janë marrë në detaje me shqyrtimin e meritave të të dy pretendimeve, të pretendimit nga padia dhe pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës, si dhe pagesën e të ardhurave të papaguara personale.
42. Në dritën e sa më sipër, Gjykata në arsyetimin e vendimeve të kontestuara nuk konstaton ndonjë arbitraritet në zbatimin e të drejtës materiale. Ajo gjithashtu

nuk mund të gjejë as elemente që do të tregonin parregullsi, arbitraritet ose diskriminim në marrjen e vendimeve të kontestuar në dëm të parashtruesit të kërkesës.

43. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se asgjë në rastin e prezantuar nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon se procedurat në gjykatat e rregullta ishin të padrejta ose arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të jetë e bindur se thelbi i së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur, apo se parashtruesit të kërkesës i janë mohuar garancitë procedurale, gjë që do të kishte rezultuar me shkeljen e kësaj të drejte sipas nenit 31 të Kushtetutës ose paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
44. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë (përkatësisht nenet 21, 23, 24, dhe 49), Gjykata i gjen këto pretendime të pabazuara, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë argument ose provë të vlefshme me të cilën do t'i kishte mbështetur dhe justifikuar këto shkelje të pretenduara.
45. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk pengon në asnjë mënyrë parashtruesin e kërkesës që të punojë ose të ushtrojë një profesion. Si i tillë, nuk ka asgjë në pretendimin e parashtruesit të kërkesës që justifikon konkluzionin se është shkelur e drejta e tij kushtetuese e punës.
46. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës t'i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë prova *prima facie* që tregojnë për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Ky vlerësim është në përputhje me juridiksionin e Gjykatës (shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, të 5 dhjetorit 2013).
47. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 dhjetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi